




<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

DREJTORIA PËR BUJQËSI
UPRAVA ZA POLJOPRIVREDU
DEPARTMENT OF AGRICULTURE

Tel/Fax: 0290 322 922
Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

DATA/DATUM/DATE	07.07.2026
11 NR/BR.	Zyrtare
PËR/ZA/TO	Komitetin për Politikë dhe Financa Kuvendin Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH	z.Xhavit Zariqi  Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt
NGA/OD/FROM	z. Agim Aliu  Kryetar i Komunës së Ferizajt
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim-vendim për bashkëfinacim me GLV “ Bifurkacioni”

Propozim-vendim për marrëveshje për bashkëfinacim me GLV “ Bifurkacioni” të cilin e përfaqëson zonja Hajrije Lohaj



KOMUNA E FERIZAJT
OPŠTINA UROŠEVAC
MUNICIPALITY OF FERIZAJ

Grupit Lokal të Veprimit
BIFURKACIONI

MARRËVESHJE PËR BASHKËFINANCIM NË MES TË

KOMUNËS SË FERIZAJT DHE GLV "BIFURKACIONI "

Për Implementimin e projekteve:

1. Ekzekutimi i punimeve për rrethimin e hapësirave të varrezave në fshatin Nerodime e Ulët, në gjatësi totale prej 400m.
2. Ndërtimi i urës në prockën e fshatit Softaj

Neni 1

Kjo Marrëveshje ka për qëllim zhvillimin e procedurës për finalizimin e procesit lidhur me implementimin e projektit:

Ekzekutimi i punimeve për rrethimin e hapësirave të varrezave në fshatin Nerodime e Ulët dhe ndërtimi i urës në prockën e fshatit Softaj, në vlerë prej 11,110.00€.

Neni 2

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje pajtohen me obligimet e ndërsjella si vijon:

- GLV „Bifurkacioni “ obligohet që të bashkë-financojë projektin në lartësi prej 80% apo 8,888.00 € të vlerës totale të projektit.
- Komuna e Ferizajt obligohet që të bashkë-financojë projektin në lartësi prej 20% apo 2,222.00€ të vlerës totale.

Neni 3

Realizimi i projektit: Procedura e prokurimit si dhe përzgjedhjes së kontraktorit për kryerjen e punimeve ndërtimore i zhvillon GLV „Bifurkacioni“, kurse Komuna e Ferizajt shumë e mjeteve të lartcekura do të transferoj në xhirollogarinë bankare të GLV „Bifurkacioni“ nr. **1304001200003184** në BPB Prishtinë.

Neni 4

Transferimi i mjeteve nga Komuna e Ferizajt në llogarinë e GLV “Bifurkacioni” do të realizohet pas dorëzimit të raportit përfundimtar të punëve të kryera si dhe faturës së punë kryesit.

Neni 5

GLV „Bifurkacioni“ pas përfundimit dhe finalizimit të projektit do t'i raportoj autoriteteve kompetente të Komunës së Ferizajt, respektivisht Zyrës së Kryetarit.

Neni 6

Kjo marrëveshje paraqet vullnetin e mirë të palëve nënshkruese dhe të njëjtit zotohen se do ta zbatojnë brenda periudhës së caktuar dhe në pajtim me rregullativën ligjore që rregullon fushat përkatëse sipas të cilave ndikohet ky proces.

Neni 7

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të saj nga palët.